



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2020:164627

Datë: 23.03.2021

Numri i dokumentit: 01626097

**P.nr. 572/2020**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE GJILAN – dega Viti-** Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtarës së vetme gjykuese Blerina Jakupi Ramadani, në çështjen penale ndaj të akuzuarit NN nga fshati Pozharan K. Viti, për shkak të veprës penale: mosveprimi i dispozitave shëndetësore gjatë epidemisë nga neni 250 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.2005/2020 të dt.23.11.2020, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor dhe jo publik me datë 18.03.2021, mori, shpalli dhe me dt. 23.03.2021 përpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I akuzuari NN, nga babai NN, nëna NN, e lindur NN, i lindur me dt.30.09.1965 në fshatin Pozharan, Komuna e Vitisë ku edhe jetonë, i martuar, baba i tre fëmijeve, ka të kryer fakultetin, i pa punë ,i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me nr. personal 11005793064, i lëshuar nga MPB Prishtinë, Republika e Kosovës.

### **ËSHTË FAJTOR**

Sepse,

-me datë 27.07.2020, rreth orës 9:00 në fshatin Pozharan K. Viti, i pandehuri gjatë kohës së epidemisë Covid 19 nuk ka vepruar sipas urdhërave apo vendimeve të tjera të Qëeverisë së Republikës së Kosovës edhe pse këto masa qeveria i kishte caktuar për ta luftuar apo parandaluar, ashtu që pasi që i njëjti ishte i infektuar me Covid 19 dhe sipas vendimit për karantinim me nr. 08-035/02-682, të dt. 23.07.2020 ka qenë i obliguar të hyj në karantinim deri në shërim, minimum 14 ditë, mirëpo i njëjti nuk e ka respektuar vendimin e qeverisë për të qëndruar në karantin, ku ka frekuentuar një pikë të KESCO të pagesave të energjisë elektrike,

- me çka ka kryer veprën penale: mosveprimi i dispozitave shëndetësore gjatë epidemisë nga neni 250 të KPRK-së.

Gjykata duke u bazuar në dispozitat ligjore të lartcekura, e në bazë të nenit 4, 70, 71, 81 dhe 82 të KPRK-së, dhe nenit 248 e 365 të KPRK-së, të pandehurit i shqipton:

### **VËREJTJE GJYQËSORE**

Ashtu që të pandehurit NN nga fshati Pozharan K. Viti, i bëhet me dije se ka kryer veprë të dëmshme dhe të rrezikshme që përbën veprë penale për të cilën nëse ai sërish kryen veprë të tillë gjykata do t'i shqiptojë një sanksion më të rëndë penal.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 € (njëzet euro), në afat prej 15 ditësh nga dita pasuese e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit me kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

## **A r s y e t i m**

### 1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjiilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 25.11.2020, në këtë gjykatë ka dorëzuar aktakuzën me numër PP.II.nr.2005/2020 të dt.23.11.2020, kundër të akuzuarit NN nga fshati Pozharan K. Viti, për shkak të veprës penale: mosveprimi i dispozitave shëndetësore gjatë epidemisë nga neni 250 të KPRK-së.

Gjykata me datë 18.03.2021 ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor, në të cilën ishin prezent prokurorja e shtetit Rozelida Manastiri dhe i akuzuari NN, në të cilën seancë i pandehuri pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet.

### 2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248 paragrafi 1 të KPRK-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë.

Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

### 3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri NN ka kryer veprën penale mosveprimi i dispozitave shëndetësore gjatë epidemisë nga neni 250 të KPRK-së, në kohën vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### 4.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenin 248 të KPRK-ës, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit dhe të njejtiti të shqiptohet vërejtja gjyqësore ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës ky sanksion do të jetë i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale. Gjykata me rastin shqiptimit të këtij sanksioni ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë, duke u bazuar në nenet 69,70 dhe 71 të KPRK-së ashtu që rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, se i njejtiti është penduar dhe ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, si dhe faktin se i njejtiti për herë të parë bien ndesh, ngase gjykata nuk ka patur prova se i njejtiti është recidivist, përkatësisht kryen veprë penale, ndërsa rrethana rënduese gjykata gjeti mosrespektimin nga i akuzuari ndaj vendimeve shtetwrore dhe rrezikshwminw qw paraqet kjo vepwr penale.

5.Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjykatës sanksioni i shqiptuar ndaj të pandehurit duke i marr parasysh rrethanat lartpërmendura është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, me mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe shkallën e përgjegjësisë të pandehurit.

Gjykata po ashtu ka konstatuar se me këtë sanksion mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

6.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të pandehurit, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-ës, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë ti paguajë shpenzimet procedurale sipas përlllogaritjes përfundimtare nga ana e gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzet euro), në afat prej 15 ditëve nga dita pasuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nga të cekurat e më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – dega Viti**

**P.nr.572/2020**

**Me datë: 23.03.2021**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese,  
Blerina Jakupi Ramadani**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.